



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 15.08.2023

NR.09 6967 / 2023

KONTRATË PËR FURNIZIM

Numri i kontratës: 659-23-7587-1-4-7/C436 & KKHE(VM) 23-032-147

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

ELEKTRA L.L.C., rr.Adem Jashari, 71510, Hani i Elezit, (në vazhdim "realizues Furnizimit ").me
NUI.811481887 , në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me
poshtë:

"Furnizim dhe shtrirje e fibres optike per nevoja të kamerave " numër identifikues: 659-23-6327-2-4-
7/C415 Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	"Furnizim dhe shtrirje e fibres optike per nevoja të kamerave"

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë në

2.3 Inkotermi¹ i zbatueshëm do të jetë .

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i i shërbimit duhet të jetë: **999.90** [Nëntqind e nëntëdhjetë e nëntë Euro e /90 centi]

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh realizuesit të shërbimit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.-Çmimi është i prerë dhe nuk i nënshtrohet ndryshimeve gjatë kohëzgjatjes së kontratës]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

¹ Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Avdush Bajramaliu
Pozita:	Zyrtar i Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	15.08.2023
Vula:	



Për realizuesin e furnizimit :

ELEKTRA L.L.C..

Emri:	Halide Rexhallari
Pozita:	Perfaqëzuese me autorizim
Nënshkrimi:	
Data:	15.08.2023
Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës : 659-23-7587-1-4-7/C436

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë <i>Gjykata Themelore Ferizaj Dega ne Kaçanik</i>
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	9.1	[N/A]
Sigurimi	10.1	[N/A]
Programi i ekzekutimit	11	[Kohëzgjatja e kontrates eshte me afatë prej një (1) muaji nga koha e nenshkrimit te saj]
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	Te gjitha taksat dhe tatimet mbulohen nga OE-deri ne dorezimin e furnizimit tek AK-ja
Patentat dhe licencat	13.1	[Specifikoni nëse ka ndonjë shmangie nga Neni 13 i KPK]
Cilësia e furnizimeve	18.2	Furnizimi duht te behet me at cilesi siq eshte kerkuar ne ftesen per ofertim-dosje te tenderit
Inspektimi dhe testimi	19.2	AK- do te kontrollon cilësin e furnizimit ne kohen e pranimit te tij dhe furnizimi do te pranohet nese eshte konform kesaj kontrate-fteses per ofertim] Per ecurin dhe realizimin e kesaj kontrate kujdeset Drejtoria e Administrates”
Pagesa	20.1	Pagesa do te behet pas pranimit te sherbimit ne cilesi dhe sasi ashtu siq ka percaktuar AK-ja [Pagesa do te behet brenda afatit ligjor]
Dorëzimi	21.3	Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre
Obligimet e garancionit	24.1	N/A
	24.5	[N/A]
Shërbimet pas shitjes	25.1	N/A
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Zyra e Prokurimit – Apo permes procedurave alternative per zgjidhjen e mosmarrveshjeve-si procedura e ndermjetesimit.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata themelore Ferizaj Dega ne Kaçanik] në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].